



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr. 83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

# RREGULLORE E MARKETINGUT E FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Prishtinë, 2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr. 83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

Në bazë të nenit 23 të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës me datë 30.08.2023 miratoi këtë:

## RREGULLORE TË MARKETINGUT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### NENI 1 - QËLLIMI

Kjo rregullore parashikon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve që marrin pjesë dhe janë të përfshira në përgatitjen dhe pjesëmarrjen në veprimtarinë basketbollistike në garat e FBK-së (përfshirë kategoritë e reja dhe Përfaqësueset e Kosovës), si dhe garat 3x3, klinikat e ndryshme, dhe ngjarjet e tjera që i organizon FBK-ja.

#### NENI 2 - PRONËSIA E TË DREJTAVE TË MARKETINGUT DHE TË DREJTAVE AUDIO-VIZUALE

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) si person juridik është pronare dhe bartëse e të gjitha të drejtave të marketingut dhe të drejtave audio-vizuale, të drejtat për vendosje dhe shitje të produkteve, të dhënave statistikore, të dhënave për lojëra të fatit dhe të drejtave tjera komerciale.

#### NENI 3 - TË HYRAT

Federata e Basketbollit e Kosovës mban të drejtën e realizimit të të hyrave nga marketingu dhe të drejtat televizive dhe audio-vizuale.

#### NENI 4 - FUSHËVEPRIMI

Me këtë Rregullore përcaktohen obligimet e pjesëmarrësve në gara ndaj marketingut të FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## II. LOGOJA E FBK-SË

### NENI 5 - LOGOJA

**5.1.** Logoja e Federatës përbëhet nga një skica e jashtme dhe vijëzimet e topit të basketbollit, të vendosur nën mbishkrimin Kosova dhe nën gjashtë yje të verdha të vendosura në prapavijë të kaltër.

**5.2.** Logoja e Federatës është e mbrojtur dhe duhet të përdoret vetëm në të gjitha komunikimet zyrtare të Federatës. Përdorimi i logos së Federatës nga subjektet tjera mund të bëhet vetëm me leje paraprake të Bordit të Federatës.

**5.3.** Logo e FBK-së duhet të përdoret vetëm me marrëveshje dhe assesi të keqpërdoret. Në të kundërtën, palët do të ndiqen penalisht sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës.

**5.4.** Logo mund të përdoret vetëm sipas standardeve të përcaktuara nga "Brandbook"-u i logos së FBK-së, i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregullore në formë aneksi (Aneksi 1).

**5.5.** Nuk lejohet ndërrim i ngjyrës, emrit, aspektit, formatit apo madhësisë të logos të FBK-së dhe logoja duhet vendoset në pjesët ku është e dallueshme.

**5.6.** Logo e FBK-së nuk lejohet të përdoret për qëllime komerciale.

**5.7.** Palët e interesuara mund të përdorin logon e FBK-së në ueb-faqen, fotografi, video e print, por vetëm me leje paraprake.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





### III. SPONSORIZIMI

#### NENI 6 - SPONSORIZIMI I FEDERATËS

**6.1.** Sponsorizimi bëhet në përputhshmëri me Ligjin Nr. 05/L -090 për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Për më shumë, FBK dhe sponsori lidhin marrëveshje për sponsorizim, e cila tutje përcakton kushtet, kategorinë e sponsorizimit, të drejtat dhe obligimet e palëve, parimin e ekskluzivitetit dhe çështje të tjera.

**6.2.** Përcaktimi i sponsorëve bëhet sipas Udhëzuesit për Kategorizimin e Sponsorëve të FBK-së.

### IV. FUSHA E LOJËS, PAJISJET DHE LOJTARËT

#### NENI 7 - KOSHAT

Klubet që përdorin konstruksione të koshave të ankoruar, sipas rregullave të FIBA-s, kanë të drejtë të përdorin pjesën e sfungjerit mbrojtës të koshit për vendosje të reklamave.

#### NENI 8 - HAPËSARIT REKLAMUESE LED

**8.1.** Hapësira reklamuese në LED mes klubeve dhe FBK-së është e rregulluar sipas Doracakut për Shfrytëzimin e Hapësirave Reklamuese LED për Klubet e Prince Caffè Superligës së Kosovës në Basketboll, i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregullore në formë Aneksi (Aneksi 2).

**8.2.** Hapësira reklamuese në sistemin LED do të ndahet mes ekipeve nikoqire dhe FBK-së, në proporcionin e përcaktuar nga FIBA për garat elitare të saj. Klubet nikoqire do të kenë të drejtë të vendosjes së deri në 16 logo të sponsorëve të tyre, përfshirë edhe logot e komunave përkatëse në rast se të njëjtat përkrahin veprimtarinë e klubeve, ndërsa FBK ruan të drejtën e

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





vendosjes së 8 reklamave të veta pas çdo rotacioni të 16 reklamave të ekipit nikoqir. Reklammat do të jenë të ndara mes vete me logot përkatëse të FBK-së dhe klubit nikoqir.

## NENI 9 - BILETAT DHE MATERIALI PROMOVUES

**9.1.** Klubet obligohen që të vendosin logon e FBK-së (ose të Ligës përkatëse) në biletat e ndeshjeve dhe materialin promovues të ndeshjeve (posterë, fletushka, fletëpalosje, video promo, grafika promovuese dhe materialet tjera promovuese).

**9.2.** Logo e FBK-së duhet të jetë e pranishme në çdo ueb-faqe dhe rrjete sociale të klubeve pjesëmarrëse më së largu 14 ditë para ndeshjes së parë.

**9.3.** Linku i ueb-faqes së FBK-së duhet të jetë i pranishëm në çdo ueb-faqe të klubeve pjesëmarrëse. Logo e FBK-së duhet të jetë e pranishme në të gjitha konferencat për media të organizuara në kuadër të garave.

**9.4.** Federata e Basketbollit e Kosovës do t'i dhurojë secilit klub nga një flamur dhe i njëjti flamur duhet të vendoset në palestër para çdo ndeshje.

**9.5.** Çdo material promovues që ka të bëjë me Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe që printohet duhet të ketë të pranishme logon e FBK-së.

## NENI 10 - REKLAMAT TELEVIZIVE

**10.1.** Federata e Basketbollit e Kosovës iu siguron klubeve hapësirë reklamuese për sponsorët e tyre në transmetimet televizive të ndeshjeve, detajet teknike të së cilave saktësohen në marrëveshjen me sponsorin medial.

**10.2.** Si parim, formula e ndarjes së hapësirës së përgjithshme reklamuese në transmetime televizive është: 50% e hapësirës për ekipin vendës, 225

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





sekonda. 25% e hapësirës për ekipin mysafir, 112.5 sekonda. 25% e hapësirës për sponsorët e FBK-së, 112.5 sekonda.

**10.3.** Ekipet obligohen që me kohë të dërgojnë reklamat e tyre për transmetim dhe të koordinohen me zyrtarin e FBK-së për marketing.

## NENI 11 - MARKETINGU NË UNIFORMA DHE PAJISJE SPORTIVE

**11.1.** Ekipet janë të obliguara që në fanellat e lojtarëve dhe në fanellat për nxehje (warm up shirts) të vendosin logon - emblemën e FBK-së, në formatin e dhënë paraprakisht nga kjo e fundit. Emblema duhet të vendoset në anën e majtë të epërme të fanellës dhe dimensionet e saj nuk guxojnë të jenë më të vogla se 8 cm x 5 cm. Ekipet janë të obliguara që në pjesën e pasme (në mes) të fanellave të lojtarëve të vendosin edhe flamurin e Republikës së Kosovës.

**11.2.** Klubeve iu lejohen 3 hapësira reklamuese në pjesën e përparme të fanellës dhe dy hapësira reklamuese në pjesën e pasme të fanellës, sipas modelit dhe udhëzimeve në këtë rregullore.

**11.3.** Ekipet janë të obliguara që në shorcet e lojës, në këmbën e majtë, të vendosin logon e FBK-së dhe numrin e lojtarit. Në këmbën e djathtë, klubet kanë të drejtë të vendosjes së dy logove të sponsorëve, sipas modelit dhe udhëzimeve në këtë rregullore.

**11.4.** Për pjesën tjera të uniformës së lojtarëve (çorapet, mangët, shtrënguesit, kompresuesit) vlejnë rregullat e FIBA-s dhe dispozitat e Propozicioneve të Garave.

## NENI 12 - UNIFORMAT E GJYQITARËVE

Vendosja e reklamave në uniformat e gjyqtarëve dhe dizajni i tyre miratohen nga Bordi Drejtues i FBK-se dhe gjyqtarët dhe ekipet njoftohen me kohë.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





## NENI 13 - PERSONI PËRGJEGJËS PËR MARKETING

**13.1.** Për të realizuar dispozitat e kësaj Rregullore, Federata e Basketbollit e Kosovës e ka caktuar një person kontaktues për reklamat, kurse të njëjtën gjë duhet ta bëjnë edhe klubet, pra ta caktojnë një person kontaktues për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me personin e emëruar nga FBK.

**13.2.** Klubet janë të obliguara të caktojnë një person përgjegjës për marketing, i cili mban komunikim të rregullt me zyrën e FBK-së.

**13.3.** Për çdo ndryshim në reklamat e sponsorëve të ekipit, një javë para ndeshjes duhet të lajmërohet zyrtari i marketingut i FBK-së.

**13.4.** Ekipet e Prince Caffè Superligës duhet t'i dërgojnë më së largu dy ditë para ndeshjeve reklamat e tyre që do të vendosin në sistemin LED, në formatin grafik të kërkuar nga FBK dhe operatori i kontraktuar për këtë qëllim nga FBK.

## NENI 14 - FOTOGRAFITË

Klubet obligohen që pas ndeshjes të dërgojnë në emailin zyrtar të FBK-së fotografi profesionale të zhvillimeve interesante në ndeshjes. Në rast se klubet postojnë në faqet e tyre në internet ose rrjete sociale, fotografi nga ndeshjet, fotografitë duhet të përmbajnë logon e FBK-së dhe sponsorit kryesor. Klubet obligohen të rezervojnë hapësirë të veçantë në sallë për fotografët dhe gazetarët sipas Manualit të FIBA-s.

## NENI 15 - TË DREJTAT E IMAZHIT DHE PAMJET E LOJTARËVE

**15.1.** Federata e Basketbollit të Kosovës mund të përdorë të gjitha të drejtat e imazhit dhe pamjeve të lojtarëve, klubeve dhe ndeshjeve dhe mund të përdorë fotografi, grafika, pamje, ose materiale tjera audio-vizuale

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





me qëllim të realizimit të promote, reklamave, me kërkesë të marketingut të ligës ose sponsorëve.

**15.2.** Palët e lart-përmendura kuptojnë se ky nen nuk jep të drejtën e pagesës për këtë lmazh.

**15.3.** Lojtari/ja që përfaqëson shtetin e Kosovës ka për obligim të jetë në dispozicion për nevojat zyrtare të Federatës, përfshirë promocionet, manifestimet për sponsorë dhe organizimet tjera, me njoftim dhe pëlqim paraprak.

## NENI 16 - SPONSORËT TEKNIK DHE FURNIZUES

**16.1.** Në rast se FBK nënshkruan kontrata me sponsorë teknikë dhe sponsorë furnizues (topa, ujë, peshqirë, pajisje sportive), përdorimi i këtyre produkteve do të specifikohet në kontrata e FBK-së me sponsorë dhe klubet do të informohen me shkrim për obligimet e tyre.

**16.2.** Shkelja e dispozitave të atyre kontratave do të trajtohet si shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje.

## NENI 17 - TË DREJTAT TELEVIZIVE DHE AUDIO-VIZUALE

**17.1.** Sipas Statutit të FBK-së, FBK është pronare e vetme e të drejtave të transmetimit audio-vizual të ndeshjeve të organizuara në garat nën ombrellën e Federatës.

**17.2.** Federatat ka të drejtën e menaxhimit, shitjes, rishitjes në mënyrë vetanake ose në partneritet me ndonjë biznes tjetër, të këtyre të drejtave, me qëllim që mjetet e grumbulluara në këtë mënyrë të shfrytëzohen për avancimin e qëllimeve të përcaktuara me Statut. Mjetet e grumbulluara nga shitjet e tilla do të ndahen me klubet anëtare të Federatës, në bazë të formulave të përcaktuara me aktin normativ të Federatës mbi ndarjen e të

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:







hyrave nga transmetimet audio-vizuale, e cila do të miratohet nga Bordi i Federatës.

**17.3.** Të drejtat televizive dhe audio-vizuale rregullohen më tutje në Rregulloren mbi të Drejtat dhe Transmetimet Audio Vizuale të FBK-së.

## V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

### NENI 18 - SHKELJA E KËSAJ RREGULLORE

Shkeljet ndaj marketingut të FBK-së dhe të drejtave televizive e mediale (gjegjësisht shkeljet e kësaj Rregullore), sanksionohen sipas akteve normative përkatëse të FBK-së, gjegjësisht Propozicioneve të Garave të FBK-së.

### NENI 19 - DËMET E MATERIALEVE PROMOVUESE

**20.1.** Në rast se klubet dëmtojnë, humbin, prishin apo nxjerrin nga funksioni çfarëdo materiali promovues që iu sigurohet atyre nga FBK, obligohen që ta bëjnë zëvendësimin e këtyre materialeve me shpenzime të veta.

**20.2.** Në rast të LED reklamave, klubet duhet të veprojnë sipas Doracakut për Shfrytëzimin e Hapësirave Reklamuese LED për Klubet e Prince Caffè Superligës së Kosovës në Basketboll.

### NENI 20 - SHKELJET INDIVIDUALE

Klubet janë përgjegjëse për shkeljet individuale të lojtarëve, trajnerëve dhe anëtarëve të tjerë të delegacionit të tyre ndaj marketingut të FBK-së.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit  
të Kosovës  
+383 49 738 080  
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"  
Blloku C3, Nr. 83  
Str: Radovan Zogovic  
10 000 Prishtina

## NENI 21 - FINAL 8 DHE SUPERKUPA E KOSOVËS

Në FINAL 8 dhe Superkupën e Kosovës vlejnë rregulla të posaçme të marketingut, të cilat janë të përcaktuara në Udhëzuesit për organizimin e këtyre dy eventeve.

## NENI 23 - INTERPRETIMI

Interpretimin e kësaj Rregullore e bën Bordi i FBK-së.

Arben **FETAHU**

Kryetar



Federata e Basketbollit të Kosovës

Prishtinë, 30.08.2023

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

